



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:107087

Datë: 30.09.2021

Numri i dokumentit: 02232712

C.nr.309/20

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me procesmbajtësin Xhavit Morina, në çështjen juridike të paditësja N.M. nga fshati V. me vendbanim në M., të cilin e ka përfaqësuar Av. Ramadan Paçarizi nga Malisheva, ndaj të paditurës K.e M.- D. e A. të cilën e ka përfaqësuar Avokati Publik Komunal M. S., sipas bazës juridike kompensim i shujtës ditore, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës 21.09.2021 ndërsa më datë, 30.09.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësja N. M. nga fshati V. me vendbanim në Malishevë.
- II. DETYROHET** e paditura K. e M. – D. që paditëses N. M. nga fshati V. me vendbanim në Malishevë, në emër të shujtës ditore, për 348 ditë pune për periudhën nga data 01.01.2019 e deri 31.05.2021, të përlllogaritur sipas shumës prej 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **696 euro**, me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 30.09.2021, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 260 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj Av. Ramadan Paçarizi nga Malisheva, në këtë gjykatë me date 25.08.2020 ka parashtruar padi ndaj të paditurës K. e M.- D. e A. lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit duke theksuar nder tjera se paditësja është e punësuar në Sektorin respektivisht si motër edukatore ne çerdhen publike - shtetërore “Z. e Ë.” ne M., sipas Kontratës së Punës, qe nga viti 2015 kur edhe është themeluar ky institucion arsimor. Paditësja ka paraqitur kërkesë me shkrim tek e paditura per kompensimin e shujtës ditore gjate periudhës kohore te punës që nga data 01.01.2019, 2018, 2019, 2020 dhe për kompensimin e udhëtimit por ende nuk ka pranuar përgjigje, e për me shume si ne referatin e kësaj padie. Në fund gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, duke e detyruar të paditurën në pagesën e shujtës si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësja e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

I autorizuari i paditëses në seancën përgatitore dhe të shqyrtimit kryesor të mbajtur njëkohësisht me date 21.09.2021, ndër të tjera ka deklaruar se fillimisht gjykatës si provë në këtë seancë ja ofroj vërtetimin e llogaritjeve të ditëve të punës për paditësen e lëshuar nga punëdhënësi me dt. 10.08.2021. Bazuar në këtë provë tani në këtë seancë e precizojmë kërkesëpadia në emër të kompensimit të ushqimit për 348 ditë pune për periudhën nga dt. 01.01.2019 deri me dt. 30.07.2021 duke e llogaritur nga 2 euro në ditë e në shumën e përgjithshme 696 euro me kamat ligjore që nga nxjerrja e aktgjykimit të gjykatës si dhe shpenzimet e procedurës të cilat do të precizojmë në fjalinë përfundimtare. Ky precizimin mbështet në kontratën kolektive të dt. 18.04.2017 dhe dt. 21.01.2021 e të cilat parashihet kompensim në emër të shujtës ditore përkatësisht i njihet kjo e drejtë nga të dy kontratat në fjalë e për të cilat e paditura edhe për kundër se është e obliguar deri me tani nuk i ka kompensuar këtë detyrim. Ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadiës në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga pjesë tërhiqem për arsye se paditësja jeton këtu në Malishevë çka do të thotë se e njëjta nga vendbanimi i saj nuk ka bërë shpenzime të udhëtimit për në vendin e punës. Sa i përket faktit se a ushqehet paditësja në çerdhe në kemi bërë kërkesë në D. mirëpo nuk kemi marrë ndonjë përgjigje deri me tani prandaj me bindje të plotë duke u bazuar në deklarin e paditëses se e njëjta nuk ushqehet në çerdhe. Në rast se deri në parashtrimin e fjalës përfundimtare sigurojmë përgjigje nga D. për kërkesën tone në gjykatës do të bashkëngjisim si prove. Për t'ua argumentuar faktin se është parashtruar një kërkesë e tillë në D., gjykatës i deponojmë kërkesën e datës 10.09.2021 e protokolluar sipas numrit Prova tjera nuk kemi dhe ndonjë propozim konkret. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 29.09.2021 ka bërë rregullimin e ditëve të punës duke kërkuar që në ndryshim nga seanca e kaluar të llogariten ditët e punës prej datës 18.04.2017 kur edhe ka hyrë në fuqi dhe aplikohet kontrata kolektive me arsyet si baze ligjore në të cilën e mbështesim padinë dhe kërkesëpadinë. Në këtë parashtrime i njëjti e precizon kërkesëpadinë duke ritheksuar që për paditësen numri i ditëve të punës që duhet kompensuar për shujtë ditore në punë është 348 ditë pune x 2 euro = 696 euro dhe si provë gjykatës i deponon vërtetimin e ditëve të punës të korrigjuar me nr. 321/21.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar sipas përlllogaritjes së gjykatës.

Përfaqësuesi i autorizuari i të paditurës Avokati Publik Komunal në seancën përgatitore dhe të shqyrtimit kryesor të mbajtur njëkohësisht me date 21.09.2021, ndër të tjera ka deklaruar e kontestojmë kërkesëpadiës e precizuar të paditëses si të pa bazuar pasi që K. nuk ka qenë nënshkruese e kontratës kolektive por nënshkruese e saj ka qenë Qeveria e Kosovës - MASHT dhe kjo ministri nuk ka nda buxhet lidhur me kompensimin e detyrimeve që rrjedhin sipas kësaj kontrate po ashtu e kontestojmë edhe pjesën tjetër të kontratës të kolektivitetit të vitit 2021 pasi që e njëjta në nenin 35 të saj e përcakton që “detyrimet financiare që rrjedhin nga kjo kontratë të fillojnë të zbatohen nga 1 janar 2023”. Po ashtu paditësi punon në çerdhe dhe në këtë çerdhe ekziston restoranti dhe meqenëse barra e provave sipas LPK-së i takon paditësit, e meqenëse deri me tani paditësi nuk e ka dëshmuar me prove se nuk ushqehet në këtë restorant të çerdhës, ne do të kërkojmë nga D. e A. të K. që ta konfirmojnë se a ushqehet paditësja në këtë restorant, e në rast se ushqehet në këtë rrethane – fakt do të paraqesim në ankese në rast se gjykata e aprovon kërkesëpadinë e paditësit pasi që tani për tani është rrethane e pasqaruar.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar duke mbetur pranë thënieve të deklaruara duke e kontestuar edhe më tej padinë e paditësit të precizuar për faktin se janë llogaritur edhe ditët ende

pa hyrë në fuqi Kontrata Kolektive dhe atë nga data 01.01.2017 ndërsa Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 pra në këtë rast nuk janë verifikuar ditët e vijueshmërisë në punë të sakta. Po ashtu nga D. e A. kemi siguruar vërtetimin që në çerdhe ekziston restoranti dhe të gjithë punëtorët mund të ushqehen për më shumë si në fjalën përfundimtare të datës 30.09.2021, ndërsa si provë gjykatës në këtë fjalë përfundimtare i dorëzon përgjigjën e D.-s nr..... dt. 29.09.2021 lidhur me kërkesën e të punësuarve në këtë çerdhe për vërtetimin e faktit se të njëjtit nuk kanë të drejtë dhe nuk ushqehen në çerdhe.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, ndërsa ka kërkuar nga gjykata që shpenzimet e paditëses t'i refuzohen.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata me propozimin dhe pëlqimin e palëve pas përfundimit të seancës përgatitore menjëherë hapi shqyrtimin kryesor duke bërë administrimin e provave dhe atë: Kërkesa e paditëses e datës 11.12.2019 e parashtruar tek e paditura dhe protokolluar me date 12.12.2019 sipas nr....., Vërtetimin nr.229/2019 dt.18.11.2019 i lëshuar nga Çerdhja për fëmije "Z. e ë." Malisheve, kërkesa e datës 10.09.2021 e paditëses drejtuar te paditurës e protokolluar me date 10.09.2021, sipas numrit ... dhe Vërtetimi nr.... i datës 10.08.2021 i lëshuar Çerdhja për fëmije "Z. e ë."

Pas vlerësimit të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura gjykata vlerëson se nuk është kontestuese që paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si motër edukatore në çerdhen publike - shtetërore "Z.e ë." në M., por kontestuese rezulton se të njëjtës nuk i janë kompensuar mjetet në emër të shujtave ditore, edhe pas kërkesës së paditëses për kompensimin e të njëjtës, për periudhën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe S. lidhur me kompensimin në emër të shujtës ditore sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se ***"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim"*** po ashtu kjo përcaktohet edhe në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 e që në këtë rast bazuar në Vërtetimi nr... i datës 10.08.2021 (dhe i korrigjuar për ditët e punës) i lëshuar nga Çerdhja për fëmije "Z. e ë.", gjykata gjeti se paditësi ka 348 ditë pune për periudhën nga data 01.01.2019 e deri 31.05.2021.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve ***"Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre"*** ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se ***"Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërjegje këtë në tërësi"***

ashtu si është e paraparë”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’u aprovojë sipas periudhës prej 01.01.2019 – 31.05.2021 përkatësisht për 348 ditë punë nga dy euro, periudhë gjatë të cilës paditësja ka punuar tek e paditura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditëses t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurës, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të S.-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (K.-D., KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**.

Gjithashtu nuk qëndron kundërshtimi i palës së paditur sa i përket fillimit të zbatimit të kontratës së arsimit të datës 01.01.2019 dhe përfundimit të saj dt. 18.04.2020 dhe të vitit 2021 që ndërlihen me ditët e punës dhe kërkesën e paditësit, kundërshtime këto të përshkruara si më lartë dhe si në fjalën përfundimtare të palës së paditur, për faktin se në kuptim nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK thuhet se **„ Nga kontrata Kolektive, palët mundë të tërhiqen tre(3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmujorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër,**, që në rastin konkret nuk kemi tërheqje nga asnjëra palë andaj edhe kjo kontratë ka vazhduar të jetë në fuqi edhe për një vit e që konsiston se paditëses e paditura është e detyruar të bëjë kompensimin e shpenzimeve për shujtë ditore edhe për periudhën nga data 18.04.2020 e deri 21.01.2021, ndërsa për periudhën nga data 21.01.2021 deri me 31.05.2021 kërkesëpapia mbështetet në kontratën kolektive të arsimit të datës 21.01.2021. Po ashtu pretendimi se paditësja ushqehet në çerdhe nuk qëndron për faktin se kjo nuk u vërtetua as me përgjigjen e të paditurës të dorëzuar me fjalën përfundimtare nr.... dt.29.09.2021 ngase në këtë përgjigje theksohet – funksioni i kuzhinës në çerdhe “Z. e ë.”, është i plotë dhe në përputhje me Kontratën Kolektive neni 35.7 të vitit 2017 çka do të thotë se nuk përcaktohet saktë se paditësja gjatë ditëve të punës ushqehet apo është ushqyer në këtë çerdhe.

Lidhur me kërkesën për kamatë, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës shumën prej 21.00 euro dhe në emër të përfaqësimit për një seancë nga avokati 135.00 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi komforë nenit 38 dhe 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C nr.309/20 datë 30.09.2021

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.